

VDEKSHMËRIA PERINATALE NË KOSOVË NË VITIN 2023

Ardita Baraku ¹, Merita Berisha ², Sevdije Spahiu ¹, Florie Miftari Basholli ¹, Mejreme Bajçinovci ¹, Sebahate Pacolli- Krasniqi ¹, Valbona Zhjeqi ², Lejlifere Shabanaj - Krasniqi ¹, Florijana Saiti ³, Djellza Thaçi - Bacaj ⁴

¹ Specialist i Shëndetësisë Publike, ² Specialist i Mjekësisë Sociale, ³ Teknike Medicinale, ⁴ Infermiere

Abstrakti

Vdekshmëria perinatale pasqyron vdekshmërinë fetale dhe vdekshmërinë e hershme neonatale së bashku për një periudhë të caktuar kohore në territor të caktuar. Ky studim synon të analizojë shkallën e vdekshmërisë perinatale në Kosovë për vitin 2023, dhe trendin e këtij indikator për periudhën 2000-2023, duke shqyrtuar komponentët kryesor të saj dhe faktorët që ndikojnë në këtë indikator të ndjeshëm të shëndetit publik. Studimi bazohet në të dhënat zyrtare të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), Departamenti i Statistikave Shëndetësore (SISh) dhe raportet e gjendjes perinatale në Kosovë. Në Kosovë, vdekshmëria perinatale për vitin 2023, ishte 9.8 ‰, ku vdekshmëria fetale ishte 5.7 ‰ dhe vdekshmëria e hershme neonatale ishte 4.1 ‰. Shkalla e vdekshmërisë perinatale në Kosovë për vitin 2023 ishte më e lartë në krahasim me vendet fqinje të rajonit dhe paraqet sfidat strukturore dhe sistematike të sistemit shëndetësor. Studimi nxjerr edhe rekomandimet për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe zvogëlimin e vdekshmërisë perinatale.

Hyrja

Vdekshmëria perinatale pasqyron vdekshmërinë fetale dhe vdekshmërinë e hershme neonatale së bashku për një periudhë të caktuar kohore në territor të caktuar [1]. Ky indikator reflekton cilësinë e kujdesit shëndetësor për nënat dhe të porsalindurit. Rëndësia e gjendjes perinatale qëndron në reflektimin e

gjendjes shëndetësore të vendit dhe cilësinë e sistemit shëndetësor dhe paraqet një nga indikatorët më të rëndësishëm të cilësisë së kujdesit shëndetësor për nënat dhe foshnjat [2]. Vdekshmëria perinatale ndihmon në matjen e performancës së sistemit shëndetësor, identifikimin e grupeve të ndjeshme të popullatës dhe orientimin e politikave shëndetësore dhe burimeve buxhetore publike. Në Kosovë, përkundër përmirësimeve të përgjithshme në sistemin shëndetësor, shkalla e vdekshmërisë perinatale mbetet shqetësuese dhe kërkon analizë të detajuar.

Qëllimi

Studimi ka për qëllim analizën e vdekshmërisë perinatale: vdekshmërisë fetale dhe vdekshmërisë neonatale të hershme, si dhe trendët e vdekshmërisë perinatale, vdekshmërisë fetale dhe neonatale të hershme për periudhën 2000-2023. Ky indikator është shqyrtuar në kontekstin e zhvillimeve shëndetësore dhe socio-ekonomike të vendit.

Metodologjia

Studimi bazohet në të dhënat zyrtare të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, raportet e gjendjes perinatale në Kosovë.

Rezultatet

Në vitin 2023, shkalla e vdekshmërisë perinatale në Kosovë ishte 9.8 ‰, nga të cilat 5.7 ‰ i përkasin vdekshmërisë fetale dhe 4.1 ‰ vdekshmërisë së hershme neonatale. Trendi i vdekshmërisë perinatale

është analizuar për periudhën 2000-2023, ky indikator tregon tendencë të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 1‰. Vdekshmëria fetale si dhe vdekshmëria e hershme neonatale gjithashtu janë analizuar për periudhën 2000-2023. Vdekshmëria fetale për periudhën 2000-2023 tregon tendencë të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.67‰, vdekshmëria e hershme neonatale për këtë periudhë tregon tendencë të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.1‰.

Tri grupet kryesore të shkaqeve të vdekjeve të foshnjat, sipas grupit të sëmundjeve, për vitin 2021 ishin:

1. Disa gjendje me origjinë në periudhën perinatale (P00-P96) me 74.4%,
2. Keqformimet e lindura, deformitetet dhe anomalitë kromozomale (Q00-Q99) 9%,
3. Simptomat, shenjat dhe rezultatet jonormale klinike dhe laboratorike të paklasifikuara gjatë (R00-R99) 2.8%.

Këto vlera të indikatorëve, tregojnë një barrë të konsiderueshme të humbjes së jetës në periudhën më kritike të jetës.

Diskutim

Shkalla e vdekshmërisë perinatale merret si një nga treguesit e gjendjes shëndetësore të një shoqërie të caktuar. Është shumë faktoriale në etiologji dhe varet nga cilësia e kujdesit shëndetësor të ofruar grave shtatzëna dhe foshnjave. Kosova vazhdon të përballet me sfida të konsiderueshme në ofrimin e kujdesit të duhur obstetrikë dhe neonatal.

Sipas të dhënave të vitit 2022, Shqipëria ka raportuar një shkallë vdekshmërie perinatale prej rreth 6.5-7.0‰ [3], me tendencë në rënie falë përmirësimeve në sistemin shëndetësor obstetrikë dhe neonatal. Maqedonia e Veriut ka një shkallë të vdekshmërisë perinatale që sillet rreth 7.2‰ [4], ndërsa Serbia ka treguar vlerë prej 5.8‰ [5].

Ngjashëm si në Kosovë [6], edhe në Shqipëri shkaqet kryesore të vdekshmërisë foshnjore për vitin 2023 ishin "Sëmundjet që shfaqen në periudhën rreth lindjes" me 49,3 %, "Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut" me 20,1 % dhe "Anomali të bashkëlindura" me 9,7 % të vdekjeve të regjistruara [7].

Krahasuar me standardet evropiane, kjo




Figura 1. Trendi i mortalitetit perinatal, 2000-2023. Burimi: Raporti i gjendjes perinatale, 2010, 2016-2023. ASK, Statistikat e vdekjeve dhe lindjeve 2000-2023.

shkallë mbetet e lartë dhe si e tillë është më se i nevojshëm përmirësimi në ofrimin e kujdesit prenatal dhe pas lindjes.

Shkalla e vdekshmërisë perinatale në Kosovë për vitin 2023 është më e lartë në krahasim me vendet fqinje të rajonit. Kjo tregon nevojën e përmirësimit të kujdesit shëndetësor prenatal dhe neonatal në vend, për të arritur standardet e vendeve fqinje dhe ato evropiane. Në Kosovë kemi qasjen e kufizuar në kujdes prenatal cilësor, mungesën e pajisjeve për kujdes intensiv neonatal, kapacitetet e pamjaftueshme profesionale në maternitetet rajonale dhe qendrore, si dhe faktorë socio-ekonomik si varfëria dhe mungesa e edukimit shëndetësor. Për më tepër, mungesa e protokolleve të standardizuara dhe moszbatimi i plotë i praktikave të bazuara në evidencë paraqesin pengesa shtesë në përmirësimin e këtyre treguesve.

Përfundim

Shkalla e vdekshmërisë perinatale në Kosovë për vitin 2023 është më e lartë në krahasim me vendet fqinje të rajonit dhe paraqet sfidat strukturore dhe sistematike të sistemit shëndetësor. Kjo tregon për nevojën e përmirësimit të kujdesit shëndetësor prenatal dhe neonatal në vend, për të arritur standardet e vendeve fqinje dhe ato evropiane.

Rekomandime

• Është e domosdoshme të fuqizohet urgjentisht qasja multidisiplinore në përmirësimin e kujdesit

prenatal, kujdesit natal përmes organizimit të aktiviteteve sipas pakos së OBSH-së "Every newborn action plan to end preventable deaths/ Plan i veprimit për çdo të porsalindur për t'i dhënë fund vdekjeve të parandalueshme".

• Hartimi i udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike relevante dhe monitorimi i zbatimit të tyre në praktikë.

• Realizimi i vlerësimit të cilësisë së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nënat dhe fëmijët.

• Fuqizimi i vazhdueshëm i edukimit profesional për punëtorët shëndetësor.

• Realizimi i programit të vizitave në shtëpi për nënat dhe fëmijët në të gjitha komunat e Kosovës.

• Zbatimi i strategjive kombëtare për kujdesin perinatal si masa të domosdoshme për të reduktuar vdekjet e parandalueshme në këtë periudhë kritike të jetës.

• Publikimi me kohë i shkaqeve të vdekjeve në Kosovë.

Për të siguruar përmirësime të qëndrueshme në gjendjen perinatale, është thelbësore që institucionet shëndetësore në Kosovë të intensifikojnë bashkëpunimin ndërsektorial me akterët rajonal dhe ndërkombëtar, përmes shkëmbimit të përvojave të bazuara në evidencë dhe implementimit të praktikave më të mira të standardizuara.

Referencat:

1.Perinatal Death, World Health Organization <https://www.sciencedirect.com/topics/medicine-and-dentistry/perinatal-death>.

2.Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2021, Departamenti i Mjekësisë Sociale Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve - IKShPK. <https://niph-rks.org/wp-content/uploads/2024/09/RAPORTI-GJENDJA-PERINATALE-NE-KOSOVE-2021.pdf>.

3.Shkaqet e vdekjeve, 2023, Instituti i Statistikave, Tiranë. <https://www.instat.gov.al/media/13621/statistika-te-shkaqeve-te-vdekjeve-2023.pdf>.

4.Infant deaths by age, by municipality, 2005-2023, MAKSTAT database, Skopje https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/en/MakStat/MakStat_Naselenie_Vitalna/325_VitStat_Op_UmrDoen_ml.px/.

5.Population - Births and deaths, Live births and deaths, January-June 2023, <https://publikacije.stat.gov.rs/G2023/Htm/G20231291.html>.

6.Shkaqet e vdekjeve në Kosovë 2021, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë <https://askapi.rks-gov.net/Custom/ba6ad5f9-ac03-4b2f-bb76-fdae540aea51.pdf>.

7.Shkaqet e vdekjeve në Shqipëri 2023, Instituti i Statistikave, Tiranë <https://www.instat.gov.al/media/13621/statistika-te-shkaqeve-te-vdekjeve-2023.pdf>.




Figura 2. Shkalla e vdekshmërisë fetale, 2000-2023. Burimi: Raporti i gjendjes perinatale, 2010, 2016-2023.IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës, 2023.




Figura 3.Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale. Burimi: ASK, Statistikat e vdekjeve, 2023.